



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 17 paragrafi 1 pika f) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 4 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4.3.5, nenit 7 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.52/2009), nenit 8 paragrafi 1 pika gj), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr. 6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e gjashtë të rregullt, e mbajtur më datën 26.06.2024, merr këtë:

### VENDIM NR.33/2024/KG

## PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË SHPRONËSIMIT TË TOKËS PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE NË LLAPLASELLË

#### Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e procedurës së shpronësimin të tokës për zgjerimin e varrezave në Llapllasellë.

#### Neni 2

Për nevojat e zgjerimit të varrezave ekzistuese në Llapllasellë është e nevojshme të shpronësohet e gjithë parcela kadastrale nr.343-47 ZK Preoc, livadh i klasit IV, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4,319 m<sup>2</sup>, në pronësi të Filić (Spasoje) Slađan 1/6, Savić (Spasoje) Slađana 1/6, Filipović (Spasoje) Violeta 1/6, Filić (Petar) Vladan 1/4, Filić (Petar) Goran 1/6.

#### Neni 3

Shpronësimi i parcelës së lartpërmendur është i domosdoshëm me qëllim të zgjerimit të varrezave ekzistuese në Llapllasellë, duke realizuar kështu interesin publik, i cili është i nevojshëm për procedurën e shpronësimin të pronës së paluajtshme.

#### Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të vendimit, në përputhje me Ligjin nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi janë përgjegjëse drejtoritë komunale.

### Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Këshillit



Milan Dimitrijević

